

RAPORTI AUDITUSIT TE PAVARUR

Për auditimin ligjor të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara
nga Partia Socialiste e Moderuar
Fushata zgjedhore 2011, Periudha 7/04/2011 - 7/05/2011

PËR: KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Bulevardi: "Dëshmoret e Kombit"
Pallati i Kongreseve, Tirane

Të nderuar zotërinj,

Unë, Hidajete Kraja (Muçaj), në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Regjistruar, bazuar në Vendimin nr.1232, dt.07.11.2011, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe Kontratës të Shërbimit Nr.6440/1, dt.17.11.2011, kam audituar pasqyrat bashkëlidhur që lidhen me financimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore, që fillon me datë 07.04.2011 me regjistrimin e Partisë Socialiste të Moderuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (si subjekt zgjedhor) dhe mbyllet me datë 07.05.2011 me përfundimin e fushatës zgjedhore të 08 Majit të vitit 2011.

Përgatitja e këtyre pasqyrave është përgjegjësi e drejtuesve të Partisë Socialiste të Moderuar. Detyra e subjektit zgjedhor është të përgatisë pasqyrat bashkëlidhur mbi bazën e arketimeve dhe pagesave.

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin e kryer. Auditimi u krye në përputhje me Standartet Nderkombetare të Auditimit, referencë të vecantë me SNA 800.

Këto standarte kërkojnë që unë të planifikoj dhe të kryej auditimin për të zotëruar siguri të arsytshme, se këto pasqyra nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare që përfshijnë: Librin e llogarive të subjektit, regjistrin e posacëm të miratuar si model, me vendim nr.266 të KQZ-së, dt.01.06.2009 si dhe pasqyrën e arketim pagesave. Auditimi përfshin gjithashtu, vlersimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlersimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Unë cmoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opiniononin tim të auditimit.

Per mendimin tim, pasqyrat bashkëlidhidhur dt.08.05.2011 e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të **Partisë Socialiste të Moderuar (PSM)** që fillon me dt.07.04.2011 dhe mbyllet me dt. 07.05.2011 është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën e arketimeve dhe të pagesave, konform ligjit nr.9228 dt.29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.

Shkodër 15.01.2012

Eksperte Kontabël e Regjistruar

Hidajete Kraja (Muçaj)

Adresa e Audituesit: Rr. "Çajupi", Pallati Fishta 2, kati 2, Shkodër.
Tel: 02249719, Cel: +355 69 40 69 929, e-mail: hydi_eka@yahoo.com

Stampa: EKSPERTE E REGJISTRUAR KONTABEL *
HIDAJETE KRAJA
DT. 21.12.00

